

Asylum Support Partnership

help and advice



March 2010

Albanian

Aplikim për Azil

Kur aplikoni për azil në Britani ju i kërkon autoriteteve (Ministrisë së Punëve të Brendshme) për t'ju njohur si refugjat. Përkufizimi i refugjatit vjen nga një pjesë e ligjit ndërkombëtar i quajtur Konventa e Kombeve të Bashkuara Lidhur me Statusin e Refugjatit e vitit 1951. Qeveria e MB do të marrë vendimin nëse ju kualifikoheni, ose jo për t'u mbrojtur si refugjat. Për t'u kualifikuar si refugjat qeveria britanike duhet të besojë se ju keni arsye për të pasur frikën, se do të persekutoheni në vendin tuaj për shkak të racës, besimit fetar, kombësisë, anëtarësisë në grupe sociale apo të një opinioni politik të caktuar.

Nga ana tjetër, ju mund të keni arsye të tjera humanitare apo detyruese, që ju shtojnë të qëndroni në Britani, mohimi i të cilave mund të dhunojë të drejtat e tua njerëzore, sipas Konventës Europiane mbi të Drejtat e Njeriut (European Convention on Human Rights). Përfaqësuesi juaj ligjor duhet të jetë në gjendje t'ju thotë nëse kjo gjë është e aplikueshme për ju. Ligjet mbi azilin dhe të drejtat e njeriut janë komplekse. Është thelbësore që ju të merrni këshilla dhe përfaqësim të mirë ligjor. Për më tepër informacion lidhur me këshillim dhe përfaqësim ligjor, shihni në faqen 5 të kësaj fletëpalosjeje. Kur aplikoni për azil, autoritetet do ju referohen si "azil kërkues". Nëse jeni nën moshën 18 vjeç dhe aplikoni personalisht për azil, normalisht ju do viheni në kontakt me shërbimet shoqërore (social services) ose me një agjenci për refugjatët.

Kush shqyrton aplikimet për azil?

Në Britani, Agjencia Britanike e Kufinjve (UK Border Agency - UKBA), në Ministrinë e Punëve të Brendshme (Home Office), është organi qeveritar përgjegjës për intervistimin e aplikantëve për azil, dhe vlerësimin e aplikimeve të tyre.

Si mund të aplikojë për azil?

Ju mund të aplikoni për azil:

- Tek nëpunësi i emigracionit, pas mbërritjes në portin e hyrjes, për shembull në aeroport, ose portin detar, ose
- pranë zyrave të Agjencisë Britanike të Kufinjve në Croydon, pasi keni hyrë në Britani. Për shembull, ju mund të keni hyrë në Britani ilegalisht ose ligjërisht me viza studentore, vizitori apo biznesi. Zyra e Azilit për prezantim ndodhet tek **Lunar House, 40 Wellesley Road, Croydon CR9 2BY**.

Është e rëndësishme që ju të aplikoni për azil sapo të hyni në Britani dhe të kërkon për këshillim ligjor sa më shpejt që të jetë e mundur.

Ç'ndodh kur unë aplikoj për azil?

UKBA shqyrton aplikimet për azil në mënyra të ndryshme. Për disa aplikime procedohet shumë shpejt. UKBA do të vendosë se si do procedojë me aplikimin tuaj pas intervistës së parë, e cila quhet intervista prezantuese. Nëse e keni të nevojshme, do t'ju sigurohet një përkthyes. Nëse preferoni, ju mund të kërkonti një përkthyes femër, ose mashkull.

Nëse keni dorëzuar kërkesën pas datës 5 Mars 2007, ju lutem lexoni si më poshtë – UKBA ka shumë të ngjarë të veprojë me aplimin tuaj siç përshkruhet në këtë fletëpalosje.

Nëse keni dorëzuar kërkesën para datës 5 Mars 2007, ka shumë mundësi që aplikimi juaj po shqyrtohet veçmas nga Direktorati Vendim-marrës për Cështjet në UKBA (Agjencia Britanike e Kufinjve të MB). Nëse aplikimi juaj ndodhet në këtë kategori, ju mund të dini më tepër për mënyrën se si UKBA (Agjencia Britanike e Kufinjve të) po i shqyrton këto aplikime në fletpalosjen: A keni aplikuar për azil para datës 5 Mars 2007 dhe nuk ju është dhënë e drejta për të qëndruar në Britani? tek faqa internetit <http://languages.refugeecouncil.org.uk>

Ç'ndodh gjatë intervistës prezantuese?

Qëllimi i kësaj interviste është që UKBA t'ju bëj pyetje bazike lidhur me detajet tuaja personale dhe menyrën e mbërritjes suaj në MB. Ata nuk duhet t'ju bëjnë pyetje të detajuara lidhur me arsyen që pse po aplikoni për azil.

Detajet personale dhe dokumentacioni

Gjatë intervistës prezantuese UKBA do t'ju marrë shenjat e gishtërinjve dhe do t'ju bëj një fotografi e cila do të vendoset në Kartën e Regjistrimit të Aplikimit (Application Registration Card – ARC). Kjo kartë vërteton se ju jeni një azil kërkues dhe mund ta përdorni atë për të siguruar shërbime të tilla, si mbështetje financiare. Çdo person në ngarkimin tuaj, për shembull partneri ose fëmijët tuaj, duhet t'ju shoqërojnë gjatë intervistës, në mënyrë që edhe detajet e tyre të përfshihen në aplikim. Në disa raste UKBA nuk do të mund t'ju japë një ARC. Në vend të saj, ju do të merrni një Letër Standart Njohjeje (Standard Acknowledgment Letter - SAL) e cila njih kërkesën tuaj për azil.

Një pjesë e madhe azil kërkuesish marrin një letër e quajtur IS96. Ajo do të thotë që ju jeni pranuar përkohësisht në Britani, ndërkohë që autoritetet po vendosin mbi aplikimin tuaj për azil dhe prej jush pritët, që gjatë kësaj periudhe të raportoni rregullisht në një qendër raportimi. Autoritetet do ju kontrollojnë nëse keni një dokument të vlefshëm me emrin dhe kombësinë tuaj të shkruar në të, dhe të cilën ju e keni përdorur për të hyrë në Britani. Ky dokument mund të jetë një pashaportë ose mjet tjetër identifikimi. Nëse nuk keni një dokument të vlefshëm identifikimi, ju duhet të shpjegoni në detaje sa më hollësisht arsyet përse nuk zotëroni një të tillë.

Nga keni ardhur

Gjatë intervistës prezantuese autoritetet do të vendosin nëse një shtet tjetër, jo në Britani, mund të jetë përgjegjës për marrjen parasysht të aplikimit tuaj për azil. Për shembull, kjo mund të ndodhë sepse ju keni udhëtuar nëpërmjet një shteti tjetër në të cilën UKBA mendon se keni aplikuar për azil.

A mund të shqyrtohet sa më shpejt aplikimi juaj?

Nëse autoritetet mendojnë se mund ta shqyrtojnë shpejt aplikimin tuaj, atëherë ky aplikim do kalojë një procedurë të shpejtë. Nëse ndodh kështu, autoritetet mund t'ju kalojnë në Qendrën e Largimit Harmondsworth (Harmondsworth Removal Centre) nëse jeni burrë, apo në Qendrën e Largimit Yarl's Wood (Yarl's Wood Removal Centre) nëse jeni grua, derisa çështja juaj për azil është vendosur përfundimisht. Nëse ju mbaheni në njërin prej këtyre qendrave, atëherë ju duhet siguruar një përfaqësues ligjor, por aplikimi juaj do të përcaktohet shumë shpejt. Megjithatë, jo të gjithë aplikantët për azil, rastet e të cilëve përcaktohen shumë shpejt mbahen në këto qendra.

A keni aplikuar për azil sa më shpejt që të jetë e mundur?

UKBA do t'ju kontrollojë nëse ju keni aplikuar për azil sa më shpejt që të ishte e mundur, pas mbërritjes suaj në Britani. Nëse përgjigja është "jo", ndoshta ju nuk do të merrni ndihmë nga qeveria për akomodim dhe/ose, shpenzime jetese. Për më shumë informacion mbi mënyrën si mund të aplikoni për ndihmë për azil shihni fletëpalosjen e titulluar "Aplikim Ndihe për Azil" në faqen e internetit <http://languages.refugeecouncil.org.uk>

Për më tepër, gjatë një interviste prezantuese gjërat e përmendura si mëposhtë kanë të ngjarë të ndodhin:

- Do t'ju jepet emri dhe numrat e telefonit të nënpunësve UKBA, të quajtur "zotëruesi i çështjes" ('case owner'), i cili do të jetë përgjegjës për kërkesën tuaj për azil nga fillimi deri në fund. Ai është përgjegjës t'ju intervistuar dhe për të marrë vendimin mbi çështjen tuaj. Zotëruesi i çështjes do të merret gjithashtu me nevojat e tua të mirëqenies dhe do të angazhohet për integritimin tuaj në Britani, nëse ju është dhënë një vendim pozitiv mbi aplikimin për azil, apo në të kundërt për largim nëse aplikimi juaj është refuzuar. Zotëruesi i çështjes është pika kontaktit më e rëndësishme për ju dhe përfaqësuesin tuaj.
- Përcaktimet për marrjen e një përfaqësuesi ligjor janë të ndryshme. Juve mund t'ju jepen detajet e kontaktit dhe një datë për të folur me përfaqësuesin tuaj ligjor, ose mund t'ju jepet një listë përfaqësuesish për t'i kontaktuar.
- Duhet t'ju jepet një kopje e shënimeve të mbajtura nga intervista prezantuese.
- Autoritetet duhet t'ju thonë që të raportoni për nevojën për t'u informuar "induction", që të merrni informacionet thelbësore për të cilat duhet të jeni në dijeni lidhur me procesin e azilit dhe jetës në Britani.

Autoritetet duhet t'ju informojnë brenda 15 ditëve për shërbimet (për shembull, mbështetjen financiare dhe akomodimin) të cilat ju keni të drejtë t'i merrni. Gjithashtu, ata duhet t'ju japin informacion lidhur me organizatat jo-qeveritare me të cilat mund të konsultoheni për këshilla dhe detajet e kontaktit të organizatave të tjera, që sigurojnë këshillime ligjore.

Ç'ndodh gjatë intervistës për azil?

Pas intervistës prezantuese, autoritetet do t'ju kërkojnë të merrni pjesë në një intervistë më të gjatë për t'ju pyetur rreth arsyeve që ju keni për të kërkuar azil. Është e rëndësishme të përpiqeni të takoheni me një përfaqësues ligjor para intervistës. Ju duhet të kërkonti dhe një përkthyes që të jetë i pranishëm gjatë intervistës nëse nevojitet. Nëse preferoni të intervistoheni nga një femër apo një mashkull, mund ta kërkonti diçka të tillë. Gjatë intervistës ju duhet të jepni sa më tepër detaje që të jetë e mundur lidhur me aplikimin tuaj për azil. Gjithashtu, duhet të dorëzoni çdo dëshmi tjetër, për shembull të dhënat mjekësore ose raportet në gazeta lidhur me atë që ka ndodhur në vendin tuaj. Është shumë e rëndësishme, që çdo informacion dhe dëshmi që ju jepni të mos jetë kontradiktore por mbështet kërkesën tuaj. Ju duhet të përfshini dhe informacione rreth familjes suaj këtu në Britani apo kudo qofshin ata, në rast se kjo mund të ndikojë në çdo aplikim të ardhshëm që ata ose ju mund të bëni.

Përfaqësuesi juaj ligjor ka shumë të ngjarë të mos marrë pjesë në intervistën tuaj për azil (Për më tepër informacion lidhur me këshillimet ligjore, shihni faqen 5). Nëse asnjë përfaqësues ligjor nuk është prezent gjatë intervistës suaj, ju mund t'i kërkonti autoriteteve që ta inçizojnë këtë intervistë në kasetë. Ju duhet t'u thoni atyre 24 orë para fillimit të intervistës nëse dëshiron që intervista të inçizohet. Nëse pas intervistës mendon se keni harruar të shprehni ndonjë informacion të rëndësishëm, ju duhet të flisni për këtë sa më shpejt me përfaqësuesin tuaj ligjor. Ai ka vetëm pesë ditë kohë për të dorëzuar informacione të mëtejshme.

Ndalimi dhe raportimi

Autoritetet kanë të drejtën të ndalojnë disa azil kërkues gjatë cilësdo fazë të aplimit për azil, por ata duhet të tregojnë se ndalimi i bërë është i nevojshëm. Shpesh herë, autoritetet ndalojnë personat kur mendojnë se mund të vendosin shumë shpejt mbi aplikim e tyre për azil, ose kur mendojnë se personi përkatës nuk do të mbajë komunikimin me ta. Nëse autoritetet vendosin t'ju ndalojnë, ata duhet t'ju komunikojnë me shkrim pse ju kanë ndaluar. Ju mund të jeni në gjëndje ta kundërshtoni këtë vendim. Dhe duhet të merrni këshillime ligjore për të negociuar lirin tuaj. Një organizatë e quajtur Garanci për të Ndaluarit Emigrant (Bail for Immigration Detainees - BID), apo grupet vizitore që vizitojnë personat e ndaluar, mund t'ju japin informacion se si të negocioni për lirin tuaj. Ju lutem shihni faqen elektronike të BID në: <http://www.biduk.org> ose telefononi në 020 7247 3590.

Pritet që shumica e aplikantëve për azil, të cilët nuk janë ndaluar, të raportojnë rregullisht tek një qendër raportimi. Nëse juve ju duhet të udhëtoni më shumë se pesë kilometra për të raportuar, ju mund të aplikoni për asistencë financiare që t'ju paguhet udhëtimin.

Ç'ndodh teksa pres për një vendim?

Ju duhet të merrni pjesë në të gjitha intervistat që autoritetet kanë kërkuar të jeni pjesmarrës. Duhet të plotësoni dhe të riktheni të gjithë formularët që ata ju kanë dhënë, brenda afateve kohore të përcaktuara. Mos realizimi i këtyre procese mund do të thotë që autoritetet do të refuzojnë aplikimin tuaj për azil, sepse ju nuk keni zbatuar të gjitha rregullat e tyre. Është e rëndësishme që gjatë kësaj kohe të informoni autoritetet nëse adresa juaj ndryshon. Ju mund t'i informoni personalisht ose mund t'ia kërkonit përfaqësuesit tuaj ligjor ta bëjë.

Ç'ndodh kur apelimi im refuzohet?

Shumica e aplikimeve për azil refuzohet, megjithatë disa prej këtyre aplikimeve më vonë do të jenë të suksesshme në procesin e apelimit. Nëse autoritetet refuzojnë aplikimin tuaj për azil ju mund të apeloni ndaj këtij refuzimi, megjithëse disa azil kërkues do mund të apelojnë vetëm atëherë kur janë larguar nga Britania. Nëse ka arsye të tjera për të cilat ju duhet të lejoheni të qëndroni, për shembull, largimi juaj nga Britania do të ishte një thyerje e të drejtatave të njeriut, këto gjëra duhen vendosur në apel. Është e rëndësishme që të kontaktoni përfaqësuesit tuaj ligjor menjëherë, për t'ju ndihmuar të depozitoni një apel, sepse do t'ju duhet ta bëni diçka të tillë brenda një afati kohor tepër strikt.

Nëse apelimi juaj refuzohet, UKBA pret që ju të largoheni nga vendi. Autoritetet mund të përpiqen t'ju largojnë me force, nëse nuk largoheni vullnetarisht.

Parashtrimi i kërkesave të mëtejshme

Nëse apelimi juaj është refuzuar, dhe ju nuk keni me të drejtë apelimi, ju mund të sillni arsye të reja, për të justifikuar lejimin e qëndrimit tuaj në Britani. Kjo quhet "parashtrim i një kërkesë të mëtejshme". Është e rëndësishme që ju të kërkonit këshillim ligjor lidhur me këtë. Kërkesat e mëtejshme mund të bëhen vetëm duke u paraqitur personalisht.


Nëse keni aplikuar për azil para datës 5 Mars të 2007 dhe dëshironi të bëni kërkesa të mëtejshme ju mund ta bëni këtë duke u paraqitur personalisht në Zyrën e Parashtrimit të Kërkesave të Mëtejshme (Liverpool Further Submissions Unit - FSU) në Liverpool. Ju duhet të lini një takim duke telefonuar në 0151 237 0980. Nëse shkoni në FSU pa lënë takim paraprak, atëherë do ju kërkohet të largoheni. Nëse keni nevojë për një përkthyes ju duhet ta përmendni këtë detaj gjatë telefonatës për të lënë takimin.

Nëse keni aplikuar për azil në datën 5 Mars të 2007 ose pas kësaj date, atëherë ju keni për detyrë që kërkesat e mëtejshme ti paraqitoni gjatë datave të rregullta të raportimit në rajonin tuaj.

Disa azil kërkues të cilët përmbushin kritere të veçanta, mund të lejohen që të parashtrojnë kërkesa të mëtejshme nëpërmjet postës dhe jo personalisht. Kontaktoni agjencinë më të afërt për refugjatët, për të gjetur se cilës kategori i përkisni ju.

Proçesi i Azilit

Kjo diagramë tregon rrugën e përgjithshme që përshkuan një aplikim për azil. Aplikimi juaj mund të jetë ndryshe – ju lutemi të pyesni një këshillues, ose një përfaqësues ligjor për më tepër informacione lidhur me çështjen tuaj.



Këshillimet ligjore

Ju mund të merrni këshillime ligjore nga një përfaqësues ligjor. Përfaqësuesit ligjor mund ta quajnë veten kërkues në emër të klientëve, avokat ose këshilltarë ligjor. Nëse nuk keni para të mjaftueshme, ju mund të mos paguani për këshillime ligjore. Përfaqësuesi juaj ligjor mund t'i kërkojë shtetit të paguajë për tarifat dhe shpenzimet e tij. Kjo gjë quhet ndihmë ligjore (legal aid). Përfaqësuesit ligjor duhet të gjejnë një përkthyes nëse ju keni nevojë për një të tillë.

Nëse aplikimi juaj për azil është refuzuar dhe ju dëshironi të apelonit, një përfaqësues ligjor mund të refuzojë ta ndjekë çështjen tuaj, nëse ai apo ajo mendon se ju nuk keni shanse të arsyeshme për të fituar në apel. Nëse diçka e tillë ndodh dhe ju mendoni se keni një çështje të që fiton, ju mund të kundërshtoni vendimin e përfaqësuesit tuaj ligjor duke apeluar para Komisionit të Shërbimeve Ligjore (Legal Services Commission - LSC). Përfaqësuesi ligjor duhet t'ju japë formularin e apelit dhe t'ju informojë si ta dorëzoni atë. Rregullat ndryshojnë nëse jeni në Skoci. Këshilli Skocez për Refugjatët (Scottish Refugee Council) mund t'ju këshillojë.

Në disa pjesë të Britanisë, numri i përfaqësuesve ligjor, që merren me çështje për azil është i kufizuar. Kjo do të thotë që juve mund t'ju duhet të udhëtoni në një zonë tjetër për të kontaktuar

një përfaqësues ligjor. Nëse ju po merrni mbështetje financiare për azil dhe nuk ka përfaqësues ligjor në zonën tuaj, atëherë përfaqësuesi juaj ligjor paguan kostot e udhëtimit për vizitën tuaj. Nëse ju keni lëvizur në një zonë tjetër nga ajo ku keni kërkuar azil, do të ishte më mirë të gjeni një përfaqësues ligjor në zonën ku ndodheni, sepse udhëtimi për takime mund të jetë i vështirë.

Është e rëndësishme që ju të merrni këshilla ligjore cilësore. Përfaqësuesi juaj ligjor duhet t'i përkasi një organizate e cila ka kontratë me Komisionin e Shërbimeve Ligjore në ligjin e emigrimit ose është një këshillues i regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit të Shërbimeve të Emigracionit (Office of the Immigration Services Commissioner – OISC)

Këto organizata duhet të kenë njëren ose të dyja logot të paraqitura:



Gjithashtu, ju mund ta kontaktoni OISC për një listë organizatash të aprovuara të cilat japin këshillime për ligjin mbi azilin. Telefon: 0845 000 0046 ose vizitoni www.oisc.gov.uk

Këshillime ligjore në Angli dhe Uells

Këshillimi Ligjor i Komunitetit (Community Legal Advice) boton një listë të përfaqësuesve ligjor në Angli dhe Uells. Telefon: 0845 345 4345 ose vizitoni <http://www.communitylegaladvice.org.uk>

Këshillime ligjore në Skoci

Shoqëria Ligjit e Skocisë (Law Society of Scotland) boton një listë të përfaqësuesve ligjor në Angli dhe Uells. Telefon: 0131 226 7411 ose vizitoni <http://www.lawscot.org.uk>

Këshillime ligjore në Irlandën e Veriu

Komisioni Shërbimeve Ligjore të Irlandës së Veriut (Northern Ireland Legal Services Commission) boton një listë të përfaqësuesve ligjor në Irlandën e Veriut, vizitoni <http://www.nilsc.org.uk>

Mënyra të tjera për të gjetur një përfaqësues ligjor

Ndihma për Azil (Asylum Aid) – <http://www.asylumaid.org.uk>

Linja telefonike për këshillime: 020 7354 9264 E Hënë: 14.00 – 16.30, E Enjte: 10.00 – 12.30

Shërbimi Këshillimi për Emigracionin (Immigration Advisory Service) –

<http://www.iasuk.org>

Shoqata e Praktikuesve të Ligjit për Emigracionin

(Immigration Law Practitioners Association) – <http://www.ilpa.org.uk>

Federata e Qendrave Ligjore (Law Centres Federation) – <http://www.lawcentres.org.uk>

Drejtësi për Refugjatët dhe Migrantët (Refugee and Migrant Justice) –

<http://www.refugee-legal-centre.org.uk>

Nuk jeni i kënaqur me përfaqësuesin tuaj ligjor?

Nëse nuk jeni i kënaqur me përfaqësuesin tuaj ligjor dhe mendoni se ju kanë përfaqësuar keq, ju mund të paraqisni një ankesë pranë Zyrës së Komisionerit për Shërbimet e Emigracionit. Telefononi 0845 000 0046 ose vizitoni faqen e tyre elektronike www.oisc.gov.uk

Informacioni në këtë fletëpalosje nuk është një shpejgim i plotë i ligjit por vetëm një udhërrëfyes. Ju lutemi kërkonit këshillim ligjor për këshilla të hollësishme.

Asylum Support Partnership consists of:

North of England Refugee Service, charity number: 1091200 www.refugee.org.uk

Refugee Action, charity number: 283660 www.refugee-action.org.uk

Refugee Council, charity number: 1014576 www.refugeecouncil.org.uk

Scottish Refugee Council, charity number: SC008639 www.scottishrefugeecouncil.org.uk

Welsh Refugee Council, charity number: 1102449 www.welshrefugeecouncil.org